

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

22.07.2022
Ora 11:00

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Edison Memolla kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej, përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zonja Ana Dhamo, drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi, drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zonjës Margarita Dedej, drejtore e shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonjës Mimoza Bidaj, drejtore e kopshtit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja |
| • Qëndresa Qytetare | Znj. T. Kurti, Z. M. Qiraxhi |

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje:

Shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Edison Memolla kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej, përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zonja Ana Dhamo, drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi, drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zonjës Margarita Dedej,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

drejtoreshë e shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonjës Mimoza Bidaj, drejtoreshë e kopshtit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”. Kjo çështje ka pas dhe shtesë në objektin e denoncimit.

Pika e dytë është, për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndrore Qytetare ndaj zotit Fatmir Juka, përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër dhe zotit Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”;

Pika e tretë ka të bëjë “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumëpartiake e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Altin Mifit Sipri”;

Pika e katërt ka të bëjë “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Ashim Hysen Tafilaku, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integritim, Qarku Shkodër;

Pika e pestë ka të bëjë, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, Qarku Durrës në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Mirë, atëherë fillojmë sipas rendit të ditës. Fillimisht me shpalljen e vendimeve për shqyrtimet administrative të denoncimeve të bëra nga Organizata Qëndrore Qytetare. Në lidhje me shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës Qëndrore Qytetare, ndaj zotit Edison Memolla kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej, përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zonja Ana Dhamo, drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi, drejtor i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rogozhinë, zonjës Margarita Dedej, drejtore e shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonjës Mimoza Bidaj, drejtore e kopshtit Rogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”. Vlerësojmë se veprimtaria e denoncuar përbën një veprimtari publike e cila është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përputhje me të gjitha parashikimet e aktit të Komisionit Rregullator. Rezulton që fondet nuk janë të vëna në dispozicion rishtas, apo të jetë bërë transferimi i fondeve publike, por rezulton që janë sipas planit buxhetor. Pjesëmarrja e kryetarit të bashkisë dhe njëherësh dhe kandidat për kryetar bashkie, provohet që është në përmbushje të detyrave të tij funksionale. Nuk rezulton që të ketë materiale propagandistike të subjektit zgjedhor dhe as thirrje për të votuar për të. Gjithashtu nga shqyrtimi dhe nga dëgjesa e palëve, por dhe nga dokumentacioni i administruar në seancat publike, kryesisht dhe fotot të cilat i janë bashkëlidhur dhe administruar. Rezulton që vënia në dispozicion e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” nga ana e përgjegjësit të kësaj qendre nuk është me qëllim për të favorizuar ndonjë subjekt politik. Kjo, pasi ka raste që të tre subjektet politike pjesëmarrëse në garë e kanë përdorur atë ambjent. Kjo në fakt është një çështje që mbetet për të diskutuar edhe më tej, nëse ambjentet e tjera do të lejohen të përdoren nga subjekte të ndryshme zgjedhore, në vijim. Në vlerësimin tonë nuk krijohet bindja se ka ndodhur favorizim për një subjekt zgjedhor, në vijim të asaj çfarë thashë që duhet apo jo të përdoret nga subjektet zgjedhore, apo kandidatët, ambjente të tilla. Pjesëmarrja e grupit artistik të nxënësve të shkollës gjatë orarit të mësimor, në lidhje me këtë konstatim dhe pretendim, vlerësojmë se nuk jemi në kushtet e shkeljeve, apo ndalimeve të Kodit Zgjedhor. Pasi qëllimi në këtë rast nuk ka qenë për fushatë elektorale në vlerësimin tonë, po thjesht një element artistik i cili i është shtuar procesit aty. Ndaj përfundimisht vendosim duke konsideruar të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

përfunduar shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj zotit Edison Memolla dhe të tjerëve. Konkludojmë se nuk ka shkelje administrative nga ana e zotit Edison Memolla kryetar i Bashkisë Rrogozhinë dhe kandidat për kryetar bashkie propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zotit Denis Dedej përgjegjës i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë, zonjës Ana Dharmo drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zonjës Margarita Dedej drejtore e Shkollës “Haxhi Qehaj” Rrogozhinë, zonjës Mimoza Bidaj drejtor i Kopshtit Rrogozhinë, zotit Hekuran Xhani në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” dhe zotit Ferdinand Saraçi në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 185

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

22.07.2022
Ora 11:07

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj zotit Fatmir Juka, përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër dhe zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:** **PD (Marash Logu)**
- **OJQ:** **Qëndresa Qytetare**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shpalljen e vendimit në lidhje me “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zotit Fatmir Juka, përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër dhe zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Vlerësojmë se veprimtaria e tyre...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres! Unë duhet të paraqes konkluzionet përfundimtare.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Z. I. Celibashi: I keni paraqitur!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Deri tani jo! Nëqoftëse ju kujtohet në seancën e fundit kërkova kohë për të përgatitur konkluzionet përfundimtare! Tani, mendoj se është shkelje procedurale që t'i jepet kohë përfaqësuesit të përgatisë konkluzionet përfundimtare dhe ndërkohë të jepet vendimi përfundimtar nga Komisioneri! Nëqoftëse ju kujtohet, unë kam kërkuar pesë ditë kohë për të përgatitur konkluzionet përfundimtare lidhur me çështjen. Kjo kohë më është aprovuar nga ana juaj. Seancat janë të regjistruara në procesverbal, kështuqë..

Z. I. Celibashi: Dakord, ti mund të kesh të drejtë, nëqoftëse do të kesh diçka më shumë nga ajo që thatë, dakord!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Konkluzionet përfundimtare, i Nderuar, janë e drejtë e tyre, pastaj se çfarë...

Z. I. Celibashi: Dakord, ju jap fjalën për të prezantuar pretendimet tuaja përfundimtare!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner! Së pari, nga ne përfaqësuesit ligjorë të Partisë Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është treguar një respekt maksimal për këto procese, nuk është e njejta gjë nga subjektet e tjera politike. Megjithatë, ne vlerësojmë se procesi nuk ka qenë i tillë. Ky proces në vetvehte, nga ana procedurale, ka pas disa shkelje, të cilat sigurisht dëmtojnë interesat e subjekteve të cilat unë përfaqësoj. Kjo duhet të jetë edhe në vëmendje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të organeve të tjera të KQZ-

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

së, në mënyrë që të mos bëhen raste të përsëritura. Psh zoti Komisioner, një shkelje e cila mund të jetë domethënëse është fakti që ka të bëjë me njoftimin e zhvillimit të seancave dëgjimore. Me shkresën me numër prot. 2548, dt. 1.06.2022 jemi njoftuar për zhvillimin e një seance në datën 31 maj 2022, ora 13:00. Pra, më 1 qershor, njoftohemi për zhvillimin e seancës më 31 maj. Kjo mendoj unë është një shkelje, e cila po themi duhet të marrë vëmendjen tuaj dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nuk mund të njoftosh një ditë më pas për zhvillimin e një seance që do të zhvillohet një ditë përpara. Kjo është e dokumentuar, sepse është një shkresë nëpërmjet të cilës ne jemi njohur zyrtarisht nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëqoftëse doni, mund t'jua vemë në dispozicion. Problemi i dytë, zoti Komisioner, që mendojmë se është shkelje procedurale, ka të bëjë edhe me atë të cilën ne e kemi ngritur edhe në seancën e kaluar që kishte të bënte me administrimin e provave. Mendoj që akti nënligjor që ka nxjerrë Komisioni Rregullator i KQZ-së, sidomos në nenin 9, për sa i përket mënyrës se si i administron provat, parashikohet, ose referohet konkretisht në Kodin e Procedurave Administrative të cilat janë detyrim për t'u respektuar edhe nga ana e administratës së KQZ-së. Unë mendoj se provat, megjithëse jemi në një proces të një natyre paksa të veçantë, në çdo rast, duhet t'i nënshtrohen parimit të ligjshmërisë. Pra, një provë që nuk vjen në formën e kërkuar nga ligji, nuk duhet të administrohet as nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Konsiderata të tjera mbi mundësinë, pamundësinë ekonomike etj., etj., këto janë sigurisht elementë të cilat mund të qëndrojnë, por në fakt ligji dhe vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 9 mars 2021 na imponon disa detyrime për sa i përket mënyrës se si kërkohen provat. Për të ardhur zoti Komisioner në seancën e sotme. Në këtë seancë, evidentuam edhe pak më herët në fakt, ju në seancën pararendëse na dhatë kohë për të paraqitur konkluzionet tona përfundimtare, që është një mënyrë ku palët pasi shqyrtojnë me kujdes të gjithë argumentat dhe debatin që


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

është zhvilluar gjatë procesit administrativ, kanë mundësi që të paraqesin qëndrimet e tyre përfundimtare. Ndërkohë ne kemi marrë një njoftim ditën e djeshme, Partia Demokratike, ka marrë një njoftim shkresor, ndërkohë që klienti që unë përfaqësoj, zoti Bushati nuk është njoftuar akoma. Megjithatë e kemi konsideruar të ezauruar meqenëse kemi të bëjmë me të njëjtin përfaqësues, por ka disa detyrime. Një nga detyrimet është ai i parashikuar në nenin 15, i cili thotë që “relacioni i hetimit administrativ i paraqitet pa vonesë Komisionerit. Komisioneri si rregull, pesë ditë nga marrja e relacionit, njofton me shkrim subjektin për t’u njohur me gjetjet dhe i kërkon këtrij të fundit të paraqesë prapsësimet në lidhje me të brenda pesë ditësh nga marrja e relacionit”. Në nenin 14, pika 2 thuhet që relacioni madje duhet të përmbajë edhe një lloj arësytimi nëqoftëse shkelja e denoncuar është apo jo e tillë. Pra, rezulton, apo jo e justifikuar. Një relacion të tillë, deri më tani, nga ana e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë dhe përfaqësuesit ligjor të saj, apo përfaqësuesit të zotit Bushati nuk është administruar. Këto, unë mendoj se janë shkelje të rëndësishme të cilat duhet të vlerësohen me seriozitet nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Përsa i përket themelit të çështjes zoti Komisioner, unë mendoj se jemi në një rast shumë të përafërt, në mos të ngjashëm, me atë vendim që ju sapo shpallët. Pra, kemi të bëjmë me një Galeri të Arteve, ku zoti Bushati ka zhvilluar një vizitë krejtësisht normale. I pashoqëruar as me logo, as me flamuj, as me materiale të tjera zgjedhore që bënin të besonin që ai ishte aty për të zhvilluar një aktivitet zgjedhor, apo një aktivitet të fushatës elektorale. Nga ana e administratës ka pas një qëndrim krejtësisht korrekt, as në mbështetje, as në përkrahje, por thjesht pritje, përcjellje dhe informim siç në fakt me të drejtë ka arësytuar përgjegjësi i Galerisë së Arteve në qytetin e Shkodrës. Galeria e Arteve në Shkodër është një institucion që është i hapur për publikun. Është një institucion që qytetarët mund ta vizitojnë. Ashtu si zoti Bushati, çdo kandidat tjetër mund ta vizitonte dhe kjo në çdo


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

rast nuk do të prezumohej, apo do të merrej në mënyrë hipotetike që institucioni po vendos në dispozicion të kandidatit ambjentet për të zhvilluar aktivitete të natyrës zgjedhore, apo elektorale. Të tilla nuk ka pasur, të tilla nuk kanë qenë siç në fakt mund të provohet edhe nga ato provat të cilat në vlerësimin tonë janë marrë në kundërshtim me ligjin në këtë proces. Megjithatë zoti Komisioner, meqenëse jemi në momentin e dhënies së vendimit, denoncuesi ka kërkuar vendosjen e sanksioneve për subjektin zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, duke mbështetur argumentin e saj në nenin 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Siç e kemi shpjeguar dhe në rastin e mëparshëm, ky nen në pikën 1 të tij ka dy kushte, sa i përket vendosjes apo jo të sanksioneve. Kushti i parë, ka të bëjë me faktin kur kundravajtjet administrative janë kryer në favor të këtij subjekti. Nuk di pse vizita e zotit Bushati në një Galeri Arti, një vizitë kaq normale, krejtësisht korrekte të institucionit, të ketë qenë ndonjë lloj favorizimi i subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Aq më tepër që nga ana e kundërt personi përgjegjës, apo drejtori është një emërim politik i partisë kundërshtare të Partisë Demokratike pra, Partia Socialiste. Kushti i dytë është që subjekti duhet të marrë dijeni dhe nuk merr masa. Nuk rezulton që në këtë rast subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë të ketë marrë dijeni për shkeljen dhe më pas të mos ketë marrë masat e kërkuara. Ky nen zoti Komisioner, në asnjë pikë të tij nuk referon te kandidati, sepse subjekt zgjedhor konsiderohet sipas nenit 63 të Kodit Zgjedhor, partia politike, ose koalicioni i partive politike të cilat paraqesin një listë kandidatësh sipas rregullave që përcaktohen në këtë kod. Pra, së pari nuk përmbush kriteret, nuk përmbush edhe kushtet për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj subjektit zgjedhor Partia Demokratike dhe së dyti, ky nen nuk mund të përdoret si bazë ligjore për sanksionimin e kandidatëve, sepse i tillë nuk është dhe rregulla të tilla për kandidatët nuk përmban. Neni 10, që është po ashtu baza ligjore mbi të cilën kërkohet sanksionimi administrativ, i vendimit nr. 9


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

dt. 24.12.2020, ka të bëjë zoti Komisioner me ata funksionarë publikë të cilët kanë detyrimin për të raportuar aktivitete të caktuara. Duke qenë se nuk e kryejnë këtë detyrim mund të sanksionohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Edhe në këtë rast, nuk mendoj se i referohet ky përcaktim subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, apo kandidatit të saj për Bashkinë Shkodër zotit Xhemal Bushati. Ne zoti Komisioner, të gjithë bashkë, pavarësisht mendimeve, apo qëndrimeve që ndajmë, të ndryshme, apo të kundërta kemi detyrimin t'i qëndrojmë dy parimeve të rëndësishme. Së pari, parimit të ligjshmërisë, pra ajo që shkruhet në ligj duhet të zbatohet dhe jo ajo që ne mund të mendojmë se është e drejtë. E dyta, kemi detyrimin t'i qëndrojmë parimit të barazisë. Parimi i ligjshmërisë është i atillë që po t'i referohemi nenit 172 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10 të vendimit nr. 9, dt, 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nuk gjejmë asnjë lloj baze dhe reference ligjore në mënyrë që të sanksionojmë në mënyrë administrative kandidatin zotin Xhemal Bushati apo subjektin zgjedhor Partia Demokratike. Parimi i barazisë na imponon që të njejtin standard i cili u mbajti në vendimmarrjen e mëparshme për kryetarin e Bashkisë së Rogozhinës, zotin Edison Memolla dhe kandidatët e tjerë, të respektohet dhe në këtë proces, ç'ka do të thotë që për sa kohë nuk bëhet fjalë për vendosje në dispozicion të ambjenteve nga ana e institucioneve shtetërore, apo nga ana e drejtorit të kësaj galerie, nuk kemi shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor të cilat më pas mund të na çonin në drejt sanksionimit administrativ të kësaj çështjeje. Këto ishin zoti Komisioner konkluzionet e mia përfundimtare. Shpresoj të jem dëgjues edhe pse ju ishit gati në momentin e dhënies së vendimit. Unë besoj se mund të ketë dhe ngarkesë dhe periudha mund të jetë e atillë, por është e rëndësishme që procesi administrativ të respektojë me përpikmëri të gjitha parimet, apo standartet e procesit të rregullt ligjor, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Logu! Në fakt ne kemi pritur që brenda pesë ditëve të depozitonit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pretendimet e fundit dhe në këtë konsideratë kemi proceduar me shpalljen. Dhënia e mundësisë për t'i prezantuar këto në këtë moment, nuk e ndryshon atë që thashë pak më përpara. Gjithësesi...


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Paraqitja e pretendimeve përfundimtare zoti Komisioner, bëhet gjithmonë në seancë. Ju keni vlerësuar që...

Z. I. Celibashi: Pretendimet do t'i bënit në seancë, por ju mund t'i paraqesnit brenda afatit pesë ditor!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ju keni vlerësuar që ky shqyrtim i kësaj seance të mos bëhej.. të bëhej me praninë e palëve, pra një proces publik dhe të gjitha aktet etj., etj., palët janë të detyruara që t'i paraqesin në seancë...

Z. I. Celibashi: Dakord, dakord, por depozitimi do të duhej të ishte bërë brenda pesë ditëve, pastaj prezantimi bëhej në seancë publike, pa diskutim. Gjithësesi edhe në vlerësim të asaj çfarë thashë pak më parë, por dhe në vlerësim të asaj çfarë dëgjuam së fundi nga ana juaj. Duke analizuar dhe gjithë çfarë u shqyrtua në këtë seancë dhe në seancat e tjera për këtë shqyrtim administrativ, vlerësojmë se veprimtaria e kryer në Galerinë e Arteve nuk përbën një veprimtari me karakter publik. Pa i hyrë fare vlerësimit në lidhje me atë se çfarë aty në ambjentet e Galerisë së Arteve ka ndodhur, në kuptim qoftë të komunikimit ndërmjet subjekteve që kanë qenë aty prezent, por edhe për të tretët. Ajo çfarë është në themel të arësytimit tonë, është fakti që kemi të bëjmë me veprimtari jo të karakterit publik. Çdo njëri prej kandidatëve nëse do të ishte rasti, është në të drejtën e tij që të bëjë vizita të karakterit të tillë. Ndoshta mund

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

të përcjellë dhe mesazhe elektorale brenda grupit, apo rrethit të vet shoqëror, sa kohë që kjo veprimtari nuk është një veprimtari e cila është njoftuar për publikun, apo ka karakter të hapur publik. Në vlerësimin tonë për ndryshe do të duhet të ishim para një kufizimi drastik edhe të një veprimtarie normale sociale të kandidatëve për deputet, apo për kryetar bashkie, apo anëtar këshilli sipas rastit. Ndaj duke e përfunduar shqyrtimin administrativ dhe denoncimin ndaj zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar të Bashkisë Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike, zotit Fatmir Juka, përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër si dhe subjektit zgjedhor Partia Demokratike, vlerësojmë:


Moskonstatimin e shkeljeve së dispozitave të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator për këto subjekte.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 186

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

22.07.2022
Ora 11:22

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Altin Mifit Sipri”.

PJESËMARRJA :


• **KQZ**

- | | |
|---|--|
| 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2.Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj |

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tretë që ka të bëjë me projektaktin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Altin Mifit Sipri”;
Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Vorë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Bernard Xhevahir Shiba, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Në bazë të nenit 164, pika 2 të Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Vorë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 23 zoti Altin Mifit Sipri, i cili ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Zgjedhjeve. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka kthyer përgjigje për verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zotit Altin Mifit Sipri, në Këshillin e Bashkisë Vorë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, vendos:

- Zoti Altin Mifit Sipri, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vorë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Altin Mifit Sipri.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 187

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Z. I. Celibashi: Në rregull, vazhdojmë!

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin, ndalimin, për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin e formularit të deklaramit të disa subjekteve, ndër të cilët dhe deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në parashikimet e nenit 138/2015. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Arshim Hysen Tafilaku, kandidat për deputet i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Shkodër, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 702. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore dhe me vendimin nr. 410, dt. 23.06.2021, ka vendosur miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për Qarkun Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit në rubrikën nr. 3 të formularit të vetëdeklarimit, ku shkruhet “Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit”, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se pyetjes nr. 1 “a jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj” i është përgjigjur me “PO” duke deklaruar se “Me vendimin nr. 1867 datë 18.07.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe nenit 406/1 K.Pr.P e dënon 40.000 (dyzetë mijë) lekë gjobë. Pyetjes “a është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga ndonjë shtet i huaj”, subjekti deklarues i është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se në vitin 2007 është dëbuar nga shteti fqinjë Breschia/Itali për një afat pesë-vjeçar për arsye dokumentacioni. Pyetjes tjetër në formularin e vetëdeklarimit “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se në vitin 2004-2007 ka qëndruar në Brescia/Itali për arsye emigrimi. Në vitin 1998-2000 ka qëndruar në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Greqi për arsye emigrimi. Bazuar në nenin 8, pika 1 të Ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për hetim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. E cila pas kryerjes së të gjithë verifikimeve përkatëse, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues zotit Ashim Hysen Tafilaku, sipas të cilit konstatohet se nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërjen e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formularin e deklarimit, apo të ndryshme nga ato që ka deklaruar. Rezulton “i dënuar” me vendim penal të formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Organizim i llotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal është dënuar me 40.000 (dyzetë mijë) lekë gjobë. Nuk rezulton “i dënuar” me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Nuk rezulton të ketë qenë “i ndaluar apo i arrestuar” nga organe ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale. Nuk rezulton të ketë qenë “i siguruar” nga ndonjë masë sigurimi personal. Rezulton me “dëbim administrativ” sipas nenit 13 të “Tekstit Unik për Emigracionin”, i subjektit nga territori kombëtar, me vendimin e Prefektit të Brescias, të vitit 2007. Pas paraqitjes së rezultatit përfundimtar të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent, i cili në fillim të vendimmarrjes konstaton nëse ekzistojnë kushtet e ndalimit për të kandiduar sipas përcaktimeve të ligjit.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë dokumentacion tjetër përveç atij që ka ardhur nga organi i prokurorisë, nuk kemi?!

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kemi!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

Z. I. Celibashi: Palët e interesuara nuk kanë sjellë?

Z. Y. Merkaç: Jo, nuk kanë sjellë!

Z. I. Celibashi: Mirë, në rregull! Mbyllim shqyrtimin administrativ në lidhje me këtë çështje dhe do të disponojmë me vendim në një kohë tjetër, të cilën do t'ia njoftojmë dhe palëve të interesuara.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



22.07.2022
Ora 11:28

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, Qarku Durrës në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:


Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja

znj. P. Doçaj

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me projektaktin “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, Qarku Durrës në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

Z. Y. Merkaj: Kandidati për deputet i Partisë Socialiste për Qarkun Durrës, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve para miratimit të listave të kandidatëve për këtë subjekt zgjedhor, ka ndërmarrë hapat e mëposhtme. Ka kërkuar informacion

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigje të shkresës sonë ka dërguar informacion se nuk është “i dënuar”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka sjellë informacionin se rezulton të ketë ndryshuar përbërjen e gjendjes civile në dt. 3.07.2006, ka ndryshuar emrin me procesverbalin nr. 111, nga Artan në Ergi. Ndërsa në vitin 2008 në dt. 5.05.2008 me procesverbalin nr. 58, ka ndryshuar emrin nga Ergi në Artan. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 146, dt.16.03.2021 ka vendosur miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste për zgjedhjet e datës 25 prill, duke qenë se subjekti nuk ka qenë në kushtet e ndalimit. Gjithashtu me vendimin 408, dt. 23.06.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, për përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe renditjen e kandidatëve për zonën zgjedhore Qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të renditjes së kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numërit të votave parapëlqyese, kandidati për deputet zoti Artan Bitri me nr. 14 i renditur në listë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e formularit të vetëdeklarimit ku rezulton në rubrikën nr. 1 “Të dhënat personale” pika “b” “Gjeneralitetet e mëparëshme të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshuar emrin nga “Ergi” në “Artan”. Gjithashtu në rubrikën nr. 3 të formularit të vetëdeklarimit, ku shkruhet “Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit”, subjekti vetëdeklarues pyetjes nr. 7 “a është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga ndonjë shtet i huaj”, subjekti deklarues i është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se është marrë masa e dënimit nga Napoli në Itali, për mungesë dokumentacioni për periudhën 2002-2012. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për hetim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila pas kryerjes së të gjithë verifikimeve përkatëse, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues, sipas të cilit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2022*

konstatohet si më poshtë. Rezulton të ketë përdorur gjeneralitete të tjera në shtetin italian që janë “Artan Tokuzi” dhe “Hasan Berisha” përveç atyre të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, apo të ndryshme nga ato të deklaruara në formular. Nuk rezulton “i dënuar” me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale nga autoritetet gjyqësore shqiptare apo të huaja. Nuk rezulton “i dënuar” me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Rezulton që gjeneralitetet e Artan Tokuzit të ketë qenë i ndaluar, arrestuar për emigracion klandestin nga Njësia Operative radiomobile e karabinierisë në Itali. Gjithashtu është liruar në datën 11 mars 2005 nga burgu, i paisur me urdhërin e lëshuar nga kuestori për të lënë territorin kombëtar italian. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve gjatë shqyrtimit administrativ, bazuar dhe në Kodin e Procedurave Administrative, duhet të njihet të paktën subjekti deklarues me përmbajtjen e vendimit të rezultatit përfundimtar të Prokurorisë së Përgjithshme. Mendojmë që shqyrtimi administrativ të vijojë duke i dhënë të drejtën subjektit vetëdeklarues të njihet me rezultatin e Prokurorisë së Përgjithshme, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Ne ia kemi komunikuar subjektit!?

Z. Y. Merkaj: I kemi komunikuar vetëm ditën dhe orën e seancës, me vendimin për rezultatin përfundimtar të Prokurorisë së Përgjithshme, jo!

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! E përmbushim dhe këtë kërkesë dhe do të vazhdojmë seancën në një ditë tjetër. E mbyllim seancën, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

